

VJOSA OSMANI

LIDHJA LEJORE

Hyrje

Kur flitet për marrëdhëniet në mes të fjalive, çfarëdo qofshin, flitet për çështje mjaft komplekse, dhe që të trajtohen ato, duhet të hetohen mekanizmat e përgjithshëm të ndërtimit dhe kuptimit të tyre. Ndërkaq, është e kuptueshme që një punim, sado i vëllimshëm që të jetë, nuk mund t'i trajtojë të gjitha përnjëherësh. Për këtë arsye në këtë punim do të merremi vetëm me një nga llojet e lidhjes, konkretisht me lidhjen lejore në disa tekste letrare dhe publicistike. Gjatë trajtimit do të kihen parasysh disa synime:

- Të shihet se si realizohet kjo lidhje;
- Të hulumtohen mjetet me të cilat realizohet kjo lidhje;
- Të klasifikohen ato, sipas marrëdhënies që realizojnë;
- Të analizohen si zgjedhje.

Për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve, fillimisht do të pasqyrohen pikëpamjet e studiuesve të ndryshëm për marrëdhëniet nënrenditëse në përgjithësi, si dhe për marrëdhëniet lejore në veçanti. Duke u bazuar në këto studime, do të ndërtohet baza teorike për të trajtuar pastaj mënyrën e realizimit të tyre në tekste konkrete. Ndërkaq, shembujt që do të përdoren në këtë punim do të jenë nga më të ndryshmit dhe do të merren kryesisht në dy veprat e Kadaresë: "*Kronikë në gur*" dhe "*Kështjella*", si dhe në të përditshmet "*Zëri*" dhe "*Koha Ditore*".

1. Klasifikimi i periudhave me nënrenditje

Para se të flasim për fjalitë e nënrenditura me marrëdhënie lejore, do të ndalemi, shkurtimisht, në klasifikimin e periudhave me nënrenditje në përgjithësi, meqenëse përkufizimi i tyre lidhet drejtpërdrejt me kriteret në të cilat janë mbështetur studiues të ndryshëm gjatë këtij kategorizimi. Së këndejmi, deri më sot, njihen tri forma kryesore të klasifikimit të fjalive të tilla (A.SH.SH, 2002: 491):

- 1) *klasifikimi funksional*,
- 2) *klasifikimi formal-gramatikor*,
- 3) *klasifikimi strukturor-semantik dhe semantik-strukturor*.

Gramatika tradicionale i ka ndarë këto fjali duke u mbështetur kryesisht në funksionin që ato kanë në fjali, megjithëse nuk ka përjashtuar

as kriteret tjera, si kriteret plotësuese. Kështu, një klasifikim të tillë, i cili merr për bazë raportet kuptimore sintaksore ndërmjet fjalive kryesore dhe varura, e gjejmë në gramatikat e Sheperit, Xhuvanit, Cipos, Rrotës etj. Sipas këtij këndvështrimi, fjalitë e varura konsiderohen si pjesë të fjalive kryesore dhe kanë funksione të përafërta, jo tërësisht identike, me gjymtyrët e fjalive. Së këndejmi, ato mund të dalin si kryefjalë, kallëzues, kundrinor, rrethanor etj.

Sheperi përdor termin *bashkëlidhje* në vend të termit *periudhë*, duke theksuar se nga dy fjali të bashkëlidhura, ajo që plotëson tjetrën merr përpara një nga lidhëzat e bashkëlidhjes (një përemër a një ndajfolje lidhore) dhe quhet fjali e varur ose e dytë. Së këndejmi, ai dallon nënrenditjen koncentrike: *U habita kur i pash që rrinin pa punë*, dhe fjalitë e varura i krahason në njëfarë mënyre me gjymtyrët themelore të fjalisë. (Ilia Dolo Sheperi, 1972:171, cituar sipas L. Rugova, S.N.GJ.L.K.SH., 23/1, 2004:428). Megjithatë, te ky autor i hasim edhe fjalitë lidhore, gjë që tregon se përveç kriterit funksional, mbështetet edhe në kriterin strukturor.

Edhe A. J. Rrota, duke tërhequr një paralele në mes të fjalive të nënrenditura dhe gjymtyrëve të fjalisë, ndjek të njëjtin kriter për klasifikimin e këtyre fjalive, pra kriterin funksional. Në këtë kriter mbështetet edhe Xhuvani, por edhe ky autor, ngjashëm me Sheperin, nuk lë anash as kriterin strukturor.

Pra, siç u pa, gramatika tradicionale i ka klasifikuar këto fjali duke u mbështetur kryesisht në funksionin që ato kanë në fjali, konkretisht në funksionin që ato kanë ndaj fjalive kryesore, apo drejtuese, megjithëse nuk ka përjashtuar edhe kriteret tjera, si kriteret plotësuese.

Më vonë, duke u parë se klasifikimi i mbështetur vetëm në këtë kriter është i pamjaftueshëm, e si rrjedhojë i kësaj edhe i paplotë, janë shfaqur vërejtje për një kategorizim të tillë. Ideja se fjalitë e nënrenditura realizohen në forma të ndryshme, ka bërë që të lindë një drejtim tjetër, i mbështetur mbi bazën strukturore të fjalive. Ky kriter, i cili ndryshe njihet si kriteri formal gramatikor, merr parasysh mjetet sintaksore me anë të të cilave lidhen fjalitë e varura me kryesoret dhe shprehen raportet kuptimore midis tyre. Prandaj, mbështetur në këtë kriter, fjalitë e varura ndahen në dy grupe:

1. **fjali të nënrenditura me anë të fjalëve lidhëse**, të cilat ndahen në dy nëngrupe:
 - a) fjali me nënrenditje lidhore të mirëfillta,
 - b) fjali me nënrenditje pyetëse të zhdrejta.

2. **fjali të nënrenditura me anë të lidhëzave (sipas kuptimit të lidhëzave)**, të cilat ndahen në: a) lidhëza kohore; b) lidhëza shkakore; c) lidhëza qëllimore; d) lidhëza rrjedhore; e) lidhëza kushtore; f) lidhëza lejore; g) lidhëza krahasore; h) lidhëza ftilluese; i) lidhëza sqaruese; j) lidhëza të ligjëratës së zhdrejtë.

Megjithatë, edhe një klasifikim i tillë, i mbështetur vetëm në mjetet me të cilat lidhen këto fjali, është konsideruar i pamjaftueshëm. Kështu, sipas Domit, shqyrtimi i lidhëzave shkëputurazi nga frazat me të cilat përdoren, nuk lejon të kapen saktë e plotësisht kuptimet e funksionet e tyre të veçanta, që shfaqen vetëm në frazë. Madje, vetë ndarja e lidhëzave sipas kuptimit vlerësohet si mjaft e vështirë, për shkak të polisemisë së shumë prej tyre. (Mahir Domi, 1971: 65) Ky autor i klasifikon fjalitë e varura në bazë të raporteve të vendosura në mes tyre edhe fjalive kryesore. Së këndejmi, ai dallon pesë grupe të këtyre fjalive: 1) *fjali të varura kryefjalore*, 2) *fjali të varura kallëzuesore*, 3) *fjali të varura përcaktore*, 4) *fjali të varura kundrinore, të drejta e të zhdrejta*, 5) *fjali të varura rrethanore (vendore, kohore, shkakjore, qëllimore, mënyrore, krahasore, rrjedhore, kushtore, lejore)* (po aty)

Edhe Prifti, duke u mbështetur në faktin se llojet e ndryshme të lidhëzave nuk shprehin aspekte të ndryshme të nënrenditjes, por aspekte kuptimore (të përmbajtjes) ose funksionale (raportet sintaksore), konsideron se fjalitë e nënrenditura nuk mund të studiohen në bazë të formës së lidhjes, por në bazë të funksionit të tyre (Stefan Prifti, 1971: 251). Së këndejmi, aspekti funksional mendohet se është më i rëndësishmi, por jo i vetmi. Prandaj, sipas këtij autori, për të klasifikuar këto fjali, duhet të mbështetemi së pari në bazën funksionale dhe këtë ta kombinojmë pastaj, me baza të tjera. (po aty) Prifti i ndan fjalitë e varura në: 1) **fjali të varura emërore**: a) *kryefjalore ose subjektore*; b) *kallëzuesore ose predikative*; c) *cilësore ose atributive*; d) *ndajshmore*, e) *kundrinore ose objektore*, dhe në **fjali të varura ndajfoljore ose rrethanore**: a) *vendore*; b) *kohore*; c) *shkakjore*; d) *qëllimore*; e) *mënyrore*; f) *krahasore*; g) *kushtore*; h) *lejore*; i) *rrjedhimore*; j) *kufizore*.

Një klasifikim i mbështetur në të dyja kriteret; në *kriterin funksional*, i cili merr për bazë funksionet e fjalive të varura, dhe në *kriterin strukturor*, përmes të cilit pasqyrohet mënyra e krijimit të marrëdhënieve kuptimore ne mes të fjalive kryesore dhe të varurave, konsiderohet se krijon mundësi të trajtohen më saktë dhe më gjerësisht fjalitë e tilla. Ky parim, i cili merr për bazë si formën, ashtu dhe përmbajtjen e këtyre fjalive, njihet si parimi *strukturor-semantik*, apo *semantik-strukturor*. Një ndarje të tillë e gjejmë

edhe në gramatikën e S. Floqit, i cili nisat nga elemente të strukturës për të arritur te kuptimi, megjithëse si kriter përcaktues e konsideron kuptimin. Së këndejmi, në bazë të klasifikimit ai e vë mjetin e lidhjes dhe korelatin. Sipas mjetit të lidhjes periudhat me nënrenditje ndahen në periudha të tipit *relativ* dhe *lidhëzor*. Ndërkaq, sipas korelatit ato ndahen në tri grupe (cit. sipas M. Totoni, 2000: 12):

1. *periudha me fjali të varur korelative,*
2. *periudha me fjali të varur jokorelative,*
3. *periudha me fjali të varur me korelat fakultativ.*

Në gramatikën e akademisë klasifikimi i periudhave bëhet duke u mbështetur në tiparet funksionale, strukturore dhe semantike, ngaqë konsiderohet se ato janë të lidhura ngushtë në mes vete. Së këndejmi, periudha përkufizohet si “*njësi e tërësishme e lidhur kuptimore, strukturore e intonacionare, e përbërë prej dy a më shumë njësisish kallëzuesore në formë fjali, në raporte të caktuara midis tyre*”. (A.SH.SH., 2002:61). Ndërkaq, *periudhë me nënrenditje quhet tërësia sintaksore e ndërlidhur organikisht për nga ana kuptimore e gramatikore, e përbërë së paku prej dy njësisish kallëzuesore në formë fjali, me raporte nënrenditjeje vartësie, midis tyre*. (A.SH.SH., 2002:479).

Sipas **L. Rugovës**, mbështetja në kriterin logjik gjatë përkufizimit të periudhës me nënrenditje dhe mbështetja në kriterin funksional gjatë klasifikimit të saj (me ndonjë element të rrallë që ngërthen strukturën e tyre), ka bërë që të mos përshkruhen plotësisht dhe në mënyrë të saktë shumë fenomene të rëndësishme sintaksore (siç është rasti me fjalitë lidhore dhe klasifikimin e tyre.) Prandaj, sipas saj, funksioni nuk do të ishte i plotë pa një strukturë të caktuar.

Së këndejmi, një klasifikim i mbështetur në të dyja kriteret; në *kriterin funksional*, i cili merr për bazë funksionet e fjalive të varura, dhe në *kriterin strukturor*, përmes të cilit pasqyrohet mënyra e krijimit të marrëdhënieve kuptimore në mes të fjalive kryesore dhe të varurave, konsiderohet se krijon mundësi të trajtohen më saktë dhe më gjerësisht fjalitë e tilla

2. Lidhja lejore

Lidhje e varur lejore konsiderohet ajo lidhje në të cilën “*fjalja e varur shpreh një veprim a gjendje që pritet të pengojë realizimin e veprimit të fjalisë drejtuese, por që nuk arrin ta ndalojë atë*”(A.SH.SH., 2002:595). Pra, fjalitë e nënrenditura lejore pasqyrojnë marrëdhënie në mes të dy rrethanave, që janë në kundërshti, apo që e përjashtojnë njëra tjetrën, por që nuk arrijnë ta realizojnë një gjë të tillë. Së këndejmi, megjithëse veprimi

i shprehur në fjalinë e varur përdoret si kundërargument i veprimit të shprehur në fjalinë kryesore, nuk është i mjaftueshëm për ta parandaluar realizimin e tij.

Raportet e kundërshtisë janë paraqitur në aspekte të ndryshme. Kështu, Menella Totoni kuptimin e kundërshtisë e ndan në pesë mënyra: (Menella Totoni, 2000:108.)

1. Si kundërvënie të dy gjymtyrëve:
Ndonëse të gjithë u shqetësuan për Kozin, asnjë nga ta nuk qëndroi me të.
2. Si kundërvënie pohim-mohim:
Megjithëse e kisha shkruar vet, nuk më pëlqente fare.
3. Si kundërvënie e brendive të fjalive që shpesh bëjnë të qartë ose nënkuptojnë një nga kundërvëniet e mësipërme:
U përkuul vetvetiu, ndonëse tuneli rreth dy metra i lartë.
4. Si kundërvënie me kuptim të përgjithshëm a të përcaktuar të një fjale me të veçantën a të përcaktuarën që nënkuptohet prej saj:
Kushdo që të fitojë, ty s'të lë njeri t'gëzosh pas qejfit. (nënkuptohet kundërvënia: kushdo-dikush).
5. Si kundërvënie shkallëzuese e tipit *jo vetëm...*, por edhe:
Edhe i vdekur të ishte, kishe kohë të ngriheshe nga varri e të vije më parë. (nënkuptohet kundërvënia: jo vetëm i gjallë, por edhe i vdekur).

Në Gramatikën e gjuhës shqipe II, në bazë të raporteve kuptimore dhe të formës së shprehjes së tyre, dallohen tre nëntipa të periudhave me fjali të varur lejore (A.SH.SH. 2002: 596):

- 1) Periudha me fjali të varur të mirëfilltë a reale;
- 2) Periudha me fjali të varur lejore përgjithësuese;
- 3) Periudha me fjali të varur lejore-kushtore.

Periudha të tilla pasqyrojnë marrëdhënie në mes të fakteve të ndryshme. Kështu, në fjalitë lejore të mirëfillta a reale, faktet e shprehura brenda tyre nuk i pengojnë faktet e shprehura në fjalitë drejtuese. Ato qëndrojnë në raporte kundërshtie, apo kushtëzimi jopengues. Prandaj, kundërshtia në këto raste konsiderohet si një shoqërim i pamjaftueshëm (S. Prifti, 1962: 407). P.sh.:

Plakat e jetës ishin shumë të forta, gjithë deje dhe kocka, megjithëse hanin shumë pak dhe gjithë ditën pinin duhan dhe kafe.

(“Kronikë në gur”, fq. 33)

Pavarësisht këtij vendimi, sipas saj, aplikacionet e pranuar deri më tash do të jenë të vlefshme edhe pasi të hapet konkursi i ri.

(Koha Ditore, 29 Shtator 2015)

Ndonëse çështja e liberalizimit të vizave nuk po shihet si ëndërr e afërt e kosovarëve për të udhëtuar lirshëm në Evropë, tashmë kosovarët nuk mund të cilësohen si totalisht të izoluar.

(Zëri, 6 maj 2014)

Në këto periudha shihet se raportet reale, të shprehura në fjalitë kryesore dhe të varura, janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, sepse të ushqyerit e pakët, dhe pirja e duhanit njëkohësisht, nuk janë pasojë logjike e të jetuarit si njerëz të fortë, apo të shëndetshëm. Të njëjtat raporte shihet se ekzistojnë edhe në shembullin e dytë dhe të tretë.

Ndërkaq, kur faktet e shprehura në fjalitë e varura shfaqen si pengesë e fuqishme për realizimin e fakteve të shprehura në fjalitë drejtuese, sado që nuk arrijnë një gjë të tillë, kemi të bëjmë me fjali të varura lejore përgjithësuese. Këto fjali shprehin lejim, cilado qoftë sasia, apo intensiteti (A.SH.SH. 2002: 599). P.sh.:

*Tani, të gjithë e dinë që, **sido që** të shkojë puna, nuk do të ketë më një hetim ndërkombëtar.*

(Zëri, 24 tetor 2015)

*Federica Mogherini ka thënë të martën në Bruksel se pret që, **kushdo që** të formojë qeverinë e Kosovës, do të ketë vullnet për të vazhduar dialogun me Beogradin dhe për të zbatuar marrëveshjet e arritura deri më tash.*

(Koha Ditore, 19 mars, 2014)

Siç u pa nga klasifikimi i mësipërm, marrëdhëniet në mes të fjalive të varura dhe fjalive drejtuese mund të jenë edhe lejore-kushtore. Në rastet e tilla, fjalia e varur nuk përmban një fakt real, por një supozim, realizimi i të cilit do të duhej të pengonte realizimin e veprimit të fjalisë drejtuese, megjithëse nuk e pengon. (A.SH.SH., 2002:601) Së këndejmi, ajo që shërben si pengesë e kapërcyeshme konsiderohet të jetë një supozim (po aty). P.sh.:

*Do ta pranoj, **edhe pse** i vetëdijshëm me ndikimin që ka standardi i raportimit serioz, të guximshëm edhe profesional i “Kohës Ditore”, megjithatë ndihem i mahnitur me fuqinë që na e atribuon Meucci, si një gazetë që mund të rrënojë misionet kaq të mëdha e të fuqishme si EULEX-i.*

(Koha Ditore, 13 Mars 2015)

*“**Edhe po** të liberalizohemi, s’kemi para për të udhëtuar”*

(Koha Ditore, 28 Shkurt 2016)

Në fjalitë e mësipërme raportet në mes të fjalive të varura dhe kryesore janë raporte kundërshtie dhe kushti njëkohësisht. Megjithatë, marrëdhëniet e tilla janë lejore, meqenëse pavarësisht kushtit të shprehur në fjalitë e varura, veprimet e paraqitura në fjalitë kryesore realizohen.

2.1. Lidhëzat lejore

Fjalitë e varur lejore, siç u theksua edhe më sipër, është mjaft e pasur, jo vetëm nga ana kuptimore, por edhe nga ana strukturore. Së këndejmi, ajo lidhet me fjalinë drejtuese me lidhëza të shumta, si: *megjithëse, ndonëse, sado që, sido që, pavarësisht se, paçka se, edhe pse, edhe në, edhe pse, edhe në qoftë se, edhe sikur* etj. Këto lidhëza, me tipare semantiko-strukturore të shumta, u japin fjalive kuptime e struktura të larmishme. Prandaj, në vazhdim do t'i trajtojmë veç e veç lidhëzat e tilla, dhe do të shohim se si dalin ato në tekste të caktuara letrare dhe publicistike, pra çfarë formash dhe kuptimesh marrin në tekstet e tilla.

2.1.1. Lidhëza *megjithëse*

Lidhëza lejore *megjithëse* shpreh raporte më të përgjithshme në mes të fjalisë së varur dhe asaj kryesore. Ky tipar e bën që të jetë një ndër lidhëzat më të shpeshta lejore, dhe më të zakonshme për të gjitha tipat e ligjërit. Ajo përdoret për të lidhur fjalitë e thjeshta brenda periudhave, të cilat zakonisht janë lejore të mirëfillta a reale. Marrëdhëniet e tilla do t'i pasqyrojmë përmes disa shembujve, të cilët janë marrë në tekste letrare dhe publicistike. P.sh.:

***Megjithëse** kishte krehur flokët shpejt e shpejt, dukej që vajza posa qe zgjuar nga gjumi.*

(“Kështjella”, f. 14)

*Ajo, **megjithëse** e mbushur me ujë të ri dhe të panjohur, mu përgjigj menjëherë*

(Kronikë në gur, f. 55)

*Ne e dinim prej kohësh që italianët ishin të këqinj, **megjithëse** mbanin rrobe të bukura gjithfarë pendësh dhe kopsash të ndritshme.*

(Kronikë në gur, f. 109)

***Megjithëse** përgatitjet ishin bërë që seanca të mbahet të hënën, më 15 shkurt, burime të gazetës kanë thënë se kjo ka pak gjasa të ndodhë, pasi partnerët e koalicionit, me përkrahjen edhe të ndërkombëtarëve janë pajtuar që pasardhësin e Atifete Jahjagës ta votojnë pas protestës së opozitës, e paralajmëruar të mbahet Ditën e Pavarësisë.*

(Koha Ditore, 15 Shkurt 2016)

Në shembujt e mësipërm, përmes lidhëzës *megjithëse* shprehet kundërshti apo papajtueshmëri midis dy fakteve. Brenda e fjalisë drejtuese

nuk është pasojë logjike e brendisë së fjalisë së varur, përkundrazi ajo është në kundërshtim me atë që pritej të ndodhte. Pra, fjalja e varur lejore përmban një fakt real i cili do të duhej të pengonte realizimin e veprimit të shprehur në fjalinë drejtuese. Megjithatë, veprimi nuk arrihet të pengohet.

Fjalitë e nënrenditura lejore, të bashkuara me lidhëzën *megjithëse*, shihet se dalin në pozicione të ndryshme, përpara, në mes, apo në prapa fjalisë kryesore.

2.1.2. Lidhëza *ndonëse*

Është, po ashtu, një ndër lidhëzat më të zakonshme, me të cilën lidhen fjalitë e varura lejore, konkretisht lejoret e mirëfillta apo reale. Edhe kjo lidhëz, sikurse lidhëza *megjithëse*, përdoret mjaft shpesh në të gjitha stilet. Prandaj, e gjejmë si në stilin e letërsisë artistike, ashtu edhe në atë publicistiko-shkencor. Ato i hasim më shpesh përpara fjalisë kryesore, megjithëse nuk janë të rralla as rastet kur përdoren në pozicione tjera. P.sh.:

Ndonëse Bashkimi Evropian vazhdimisht ka kërkuar që në administratën publike të Kosovës të dominojë konkurrenca e vlerës dhe jo nepotizmi dhe militantizmi partiak, duket se ky mesazh ka hasur në vesh të shurdhër.

(Zëri, 6 qershor, 2013)

Ndonëse, të dielën (sot) i skadon mandati i parë, produkti i punës së këtij komisioni, ende nuk i është dorëzuar themeluesit në procedurë zyrtare.

(Koha Ditore, 22 Janar 2012)

Siç shihet nga shembujt e mësipërm, faktet e shprehura në të fjalitë e varura, megjithëse janë në papajtueshmëri me faktet e shprehura në fjalitë kryesore, nuk i pengojnë ato, përkundrazi i lejojnë të ndodhin.

2.1.3. Lidhëzat *edhe pse/ edhe se*

Fjalitë e lidhura me lidhëzën *edhe pse, edhe se* kanë nuancën e shkakut jopengues; tregojnë lejim, cilido qoftë shkak (A.SH.SH., 2002:596). Në tekstet e Kadaresë këto lidhëza i gjejmë në të gjitha pozicionet, megjithëse më shpesh në fillim të fjalisë. Në të njëjtat pozicione i hasim edhe në tekstet publicistike. P.sh.:

Edhe pse një gjë e tillë nuk do të ndodhë në një të ardhme të afërt, duke e pasur parasysh faktin se njohja kundërshtohet fuqimisht nga presidenti Traian Basescu, tani duket të jetë vetëm çështje kohe kur Rumania do të zgjedhë t'i bashkohet shumicës së BE-së.

(Zëri, 4 tetor 2013)

Gërvalla: Ka deputetë që s'do votojnë Thaçinin edhe pse kanë presione nga ai.

(Zëri, 4 Shkurt 2016)

2.1.4. Lidhëzat sado që, sido që dhe pavarësisht se

Këto mjete të lidhjes tregojnë se, pavarësisht tendencës për të kundërshtuar veprimin e shprehur në fjalinë kryesore, një gjë e tillë nuk mund të arrihet. Mjetet e tilla, sidomos lidhëza *pavarësisht se*, janë mjaft të rralla në tekstet letrare. Ndërkaq, në tekstet publicistike janë shumë të zakonshme. Për të parë raportet e krijuara përmes këtyre lidhëzave, por edhe pozicionet, në të cilat dalin ato, do të paraqesim disa shembuj, të cilët janë marrë në tekste publicistike, konkretisht në gazetat “Koha Ditore” dhe “Zëri”.

Gjatë seancës fillestare, të dy të akuzuarit kanë thënë se janë të vetëdijshëm për veprimet që i kanë bërë, sado që vullnetarisht ishin larguar nga Siria, duke mos u pajtuar me rrjedhat brenda kësaj organizate. I akuzuari Livoreka është banor i komunës së Kaçanikut, kurse Behluli banor i komunës së Ferizajt.

(Koha Ditore, 14 Janar 2016)

Sido që të jetë, duket sikur kjo resolutë mund dhe do të zbrapsët; sidomos nëse një apo dy nga pesë shtetet jonjohëse ndryshojnë qëndrim.

(Koha Ditore, 4 tetor 2013)

Pavarësisht se a vijnë nga burimet e ripërtëritshme apo nga karburantet fosile, importet janë të shtrenjta dhe – sidomos gjatë kohës së krizës së madhe – nuk janë në dispozicion.

(Koha Ditore, 1 mars 2013)

2.1.5. Lidhëzat edhe pse, edhe në, edhe në qoftë se, edhe po, edhe po qe se, edhe sikur etj.

Përmes këtyre mjeteve të lidhjes, të përbëra zakonisht nga një lidhëz kushtore dhe nga lidhëza *edhe*, krijohen marrëdhënie lejore-kushtore. Fjalitë lejore-kushtore, të lidhura me këto mjete lidhëse, shprehin një kusht të lejimit. Së këndejmi, edhe pse rrethanat, në të cilat zhvillohen faktet, apo veprimet e caktuara përpiqen t'i pengojnë ato, assesi nuk arrijnë një gjë të tillë.

Lidhëzat e tilla, megjithëse janë më të zakonshme për stilin publicistik-shkencor, i hasim mjaft shpesh edhe në tekstet letrare, sidomos në sekuencat argumentuese. P.sh.:

Edhe pse një gjë e tillë nuk do të ndodhë në një të ardhme të afërt, duke e pasur parasysh faktin se njohja kundërshtohet fuqimisht nga

presidenti Traian Basescu, tani duket të jetë vetëm çështje kohe kur Rumania do të zgjedhë t'i bashkohet shumicës së BE-së.

(Koha Ditore, 4 tetor 2013)

Në fakt, **edhe në qoftë se** ju e konsideroni veten një person shumë të pastër, papastërtia, sebumi dhe qelizat e vdekura që grumbullohen në lëkurë mbesin në çarçaf dhe depozitohen çdo natë.

(Zëri, 3 tetor 2015)

Edhe sikur të tjerët të ishin të këqinj, aeroplani im nuk ishte i tillë.

(Kronikë në gur, f. 110)

Veseli: Do ta votoja Specialen **edhe sikur** ta dija që i pari arrestohem.

(Koha Ditore, 26 qershor 2015)

Siç shihet, në fjalitë e lidhura me këto lidhëza, edhe pse faktorë të ndryshëm përpiqen t'i pengojnë veprimet e caktuara, ato prapëseprapë ndodhin. Lidhëzat e tilla vërehet se hasen në të gjitha pozicionet. Pra, ato mund të dalin të paravendosura, të ndërvendosura dhe të prapavendosura. Po ashtu, vlen të theksohet edhe fakti se ato dalin kryesisht si fjali dëftore, megjithëse nuk mungojnë as rastet kur dalin si fjali pyetëse, nxitëse, dëshirore dhe thirrmore.

PËRFUNDIME

- Marrëdhënia lejore në gjuhën shqipe realizohet me lidhëza e mjete të tjera lidhëse, si: *megjithëse, ndonëse, sado që, sido që, pavarësisht se, paçka se, edhe pse, edhe në, edhe pse, edhe në qoftë se, edhe sikur etj.*
- Këto lidhëza, me tipare semantike-strukture të shumta, u japin fjalive kuptime e struktura të larmishme.
- Lidhëzat lejore përdoren në të gjitha stilet, megjithëse disa nga to janë më tipike për stilin publicistik.
- Në stilin e letërsisë artistike i gjejmë më shumë në sekuencat argumentuese.

KORPUSI

1. Zëri
2. Koha Ditore
3. Kronikë në gur
4. Kështjella

BIBLIOGRAFI

Cipo, K., *Sintaksa, Shtypshkronja* "Mihal Duri", Tiranë, 1952.
Çeliku, A., *Koherenca tekstore*, Asdreni, Shkup, 2005.

- De Beaugrande, R., *Introduction to Text Linguistics*, Longman, London, 1990.
- Dibra, K. - Varfi, N., *Gjuhësi teksti*, shblu, Tiranë, 1999.
- Domi, M., *Gramatika e gjuhës shqipe-Sintaksa*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1969
- Dhima, Th., *Sintaksa*, Tiranë, 2008
- Fjalor i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2007.
- Gramatika e Gjuhës Shqipe 1*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2002.
- Halliday, M.A.K., Hassan, R., *Cohesion in English*, Longman, London, 1976
- Lloshi, X., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas, Tiranë, 2005
- Mëniku, L., *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe (temë desertacioni)*, Tiranë, 2013
- Mulaku, L. - Kelmendi, A., *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe*, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 2002
- Prifti, S., *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të Kosovës, Prishtinë, 1971
- Rugova, B., *Gjuha e gazetave*, Koha, Prishtinë, 2009
- Rugova, B., Rugova - Sejdiu, L., *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*, Trembelat, 2015, Prishtinë.
- Totoni, M., *Frazat me nënrenditje*, Tiranë, 2000.

